



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10 Mars 2023

Nr: 161

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË ELBASAN, PËR  
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 10 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Z. Shefqet Bullari person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Elbasan

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Elbasan, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 28.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Elbasan.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 10 Mars 2023

Nr: 161  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Elbasan, për raportimin e veprimtarive publike”

*“Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator. Denoncuesi pretendon si më poshtë vijon: "Njësia 1 - Sheshi i pallateve 41 në lagjen "Beqir Dardha" po rikonstruktohet dhe po shpëton nga përmbytjet që përsëriteshin nga viti në vit sa herë që nisin shirat të gjithë atë bllok banimi.*

*Link i aktivitetit: <https://www.facebook.com/elbasanbashkia/videos/1477597932767408>*

*Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.”*

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 16.2.2023, bashkisë Ebasan i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike

Më datë 7.3.2023, bashkia Elbasan bën me dije se: *“Më datë. 23.01.2023, kryetari i bashkisë Elbasan, ka inspektuar punimet per rinstruksion nësheshin nr. 41, të lagjes "Beqir Dardha", të qytetit të Elbasanit. Kjo veprimtari është raportuar në datë 18.01.2023, në faqen e KQZ-së, nga personi raportues.”*

Nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Elbasan, ka raportuar kryerjen e aktivitetit objekt denoncimi më datë 18.1.2023.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Elbasan, nuk përbën në shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Data: 10 Mars 2023

Nr: 161

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Elbasan, për raportimin e veprimtarive publike”

## V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Shefqet Bullari, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Elbasan.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 10 Mars 2023

Nr: 161  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Elbasan, për raportimin e veprimtarive publike”